



**ODA E AVOKATËVE TË KOSOVËS  
ADVOKATSKA KOMORA KOSOVA  
KOSOVA BAR ASSOCIATION**

Në bazë të nenit 95 par.2 të Statutit të Odës së Avokatëve të Kosovës, Këshilli Drejtues i OAK së në mbledhjen e mbajtur më 29 Korrik 2020 nxjerr dhe miraton si në vijim:

**RREGULLORE PËR ORGANIZIMIN DHE PUNËN E  
KOMITETEVE**

**Kreu I.  
DISPOZITAT E PËRGJTHSHME**

**Neni 1**

1. Me këtë Rregullore të OAK-së përcaktohen standardet e themelimit të Komiteteve të përhershme dhe të përkohshme, numrin e Komiteteve të përhershme, punën dhe veprimtarinë e tyre, mënyrën e propozimit dhe përzgjedhjes së anëtarëve të Komiteteve, kriteret për anëtarë të Komiteteve, mandati i anëtarëve të Komiteteve, mënyrën e raportimit, mbikqyrja, monitorimi dhe vlerësimi i punës së Komiteteve, sigurimi i kushteve për punën e Komiteteve dhe çështje të tjera.
2. Komitetet janë forma të aktivitetit dhe veprimit të Këshillit Drejtues të OAK, përmes të cilave Këshilli Drejtues ushtron aktivitetin e përcaktuar me Statutin e Odës. Përmes aktivitetit të Komiteteve realizohet edhe misioni i Odës dhe synimet strategjike të saj. Aktivitetet e Komiteteve zhvillohen në përputhje me misionin e OAK-së.
3. Komitetet themelohen nga Këshilli Drejtues. Ato formohen në fushat e caktuara për zbatimin praktik të aktivitetit të Këshillit. Me atë rast Këshilli duhet të ketë parasysh misionin e përgjithshëm të Odës, planet për zhvillimin strategjik dhe prioritetet ekzistuese.
4. Komitetet janë bartës të ideve, parashtres të kërkesave, propozimeve dhe projekteve sipas nevojave dhe synimeve të ardhshme të OAK-së. Secili komitet duhet të zhvillojë kapacitete të këtilla. Komitetet aktivitetin e vet duhet ta mbështesin në strategjinë e Odës.

## **Kreu II ORGANIZIMI DHE KOMPETENCAT**

### **Neni 2**

1. Me vendimin për themelimin, Këshilli Drejtues do të përshkruaj fushëveprimin dhe detyrat e komitetit si dhe do të caktojë numrin e anëtarëve.
2. Komitetet do të promovojnë dhe zhvillojnë standardet nga sfera e fushëveprimit të vet, duke përpiluar dhe realizuar projekte dhe programe.
3. Për çështjet nga fushëveprimi i vet Komitetet mund t'i bëjnë kërkesa, propozime, rekomandime dhe sugjerime Këshillit Drejtues.

### **Neni 3**

1. Në fushat e aktivitetit të tij, Këshilli Drejtues i Odës do të themelojë Komitete të Përhershme.
2. OAK, do t'i ketë këto Komitete të Përhershme:
  - 1) Komitetin për Legjislacion dhe Çështje Normative,
  - 2) Komitetin për Planifikimin Strategjik,
  - 3) Komiteti për Çështje Gjinore,
  - 4) Komitetin për Etike dhe Sistem Disiplinor,
  - 5) Komiteti për Praktikant,
  - 6) Komiteti për Çështjen e Komuniteteve Joshumicë.
3. Komitetet e Përhershme kanë për obligim që Këshillit Drejtues t'i paraqesin planin vjetor të punës dhe propozim buxhetin 30 ditë para mbajtjes së Kuvendit Vjetor të OAK.

### **Neni 4**

Komitetet me qëllim të veprimit më efikas, për fushat e caktuara të aktivitetit të tyre mund të krijojnë grupe dhe seksione, punën dhe aktivitetin e të cilëve e drejtojnë dhe e mbikëqyrin vet, në procedurat e përcaktuara nga vet ata.

### **Neni 5**

1. Komitetet e Përhershme, së paku çdo 12 muaj do t'i raportojnë për punën dhe aktivitetin e tyre Këshillit Drejtues.
2. Këshilli Drejtues cakton në secilin Komitet nga një anëtarë të vet me qëllim të përcjelljes së punës së atij Komiteti.

### **Neni 6**

1. Këshilli Drejtues do të formojë Komitete të Përkohshme për çështje të caktuara të ashtuquajtura *ad-hoc*.

2. Komitetet e Përkohshme pushojnë së funksionuari me përfundimin e projektit, respektivisht zgjidhjen e çështjes për të cilën janë formuar.

### **Neni 7**

1. Këshilli Drejtues zgjedh anëtarët e Komiteteve, sipas propozimit të secilës Kryesi të Degëve Regjionale pas procesit të njoftimit dhe pas shprehjes së interesit, dhe përzgjedhjes nga kryesia e degës.

2. Në Komitete do të zgjedhen nga një anëtarë nga secila degë, deri sa anëtarët e tjerë të Komiteteve zgjedhen sipas Parimit të Proporcionalitetit sipas numrit të anëtarëve të degëve.

3. Këshilli Drejtues do të caktojë një afat që dega të bëjë propozimet në një afat të caktuar, e në rast se kryesia e degës brenda këtij afati të caktuar nuk i bënë propozimet atëherë Këshilli Drejtues do të bëjë caktimin e anëtarëve.

4. Kryetari i Komitetit drejton aktivitetin, thërret dhe udhëheq mbledhjet e Komitetit.

5. Në mungesë të kryetarit, mbledhjet i udhëheqë nënkryetari i tij.

### **Neni 8**

1. Për anëtarë të Komiteteve do të zgjedhet avokati që:

- shquhet me angazhimin dhe punën e vet;
- është entuziast;
- ka njohuri për qëllimet e organizatës dhe funksionet e Komitetit;
- e ka besimin e anëtarëve të tjerë;
- që ndaj tij nuk është shqiptuar masë disiplinore në dy vitet e fundit.

2. Për anëtarë të komiteteve mund të zgjedhen personat, përvoja e të cilëve, aftësitë dhe interesat i mbështesin objektivat e Komitetit.

3. Anëtarët janë të detyruar që të marrin pjesë në aktivitetin e Komitetit, në të cilin janë zgjedhur, t'i ndjekin takimet në mënyrë të rregullt, të kuptojnë punën dhe detyrat që u caktohen dhe të marrin përgjegjësinë për zbatimin e tyre.

4. Numri i anëtarëve të Komiteteve përcaktohet varësisht nga sfera, dedikimi dhe detyrat e Komitetit. Numri i anëtarëve të Komiteteve të Përhershme nuk mund të jetë më i vogël se 9.

### **Neni 9**

1. Mandati i anëtarëve të Komiteteve të Përhershme është katër vite me të drejtë rizgjedhje edhe për një mandat.

2. Mandati i anëtarit të Komitetit mund të përfundojë edhe para kohe:

- me vendimin e Këshillit Drejtues,
- me kërkesën e vet anëtarëve/dorëheqje apo kërkesë për lirim nga detyra,

- në rast të ç' regjistrimit nga regjistri i OAK-së,
- në rast se tri herë pa arsye nuk merr pjesë në punën dhe aktivitetin e Komitetit. Kryetari i Komitetit obligohet ta njoftojë Këshillin Drejtues për mungesën pa arsye të anëtarit të Komitetit.

### **Neni 10**

1. Në aktivitetet e Komiteteve mund të angazhohen edhe profesionistë të tjerë me njohuri të veçanta nga lëmia e fushëveprimit të Komitetit.
2. Statusi i anëtarëve nga par.1 i këtij neni përcaktohet nga Këshilli Drejtues, me vendimin për caktimin e anëtarit.

### **Neni 11**

Komitetet teknikisht ndihmohen nga administrata e Odës, respektivisht në mënyrën siç e përcakton Këshilli Drejtues.

### **Neni 12**

1. Mbledhja e Komitetit mund të mbahet dhe nxjerr përfundime, nëse në mbledhje marrin pjesë shumica e anëtarëve.
2. Komiteti nxjerr përfundime me shumicë votash të anëtarëve të pranishëm, të cilat ja paraqet Këshillit Drejtues në formë të kërkesave, propozime, sugjerimeve dhe rekomandimeve.

### **Neni 13**

Anëtarët duhet të marrin pjesë në punën e Komitetit, t'i ndjekin takimet në mënyrë të rregullt, të kuptojnë punën dhe detyrat që u caktohen dhe të marrin përgjegjësinë për zbatimin e tyre.

### **Neni 14**

1. Anëtarët e Komiteteve nuk mund ta shfrytëzojnë anëtarësinë dhe angazhimin në Komitetet për t'i siguruar vetes apo kujdo qoftë privilegje dhe beneficione të çfarëdo natyre, për të ngritur rëndësinë në organizatë apo për të shtuar famën.
2. Asnjë anëtar i Komitetit nuk mund ta shfrytëzojë anëtarësinë në Komitet për ta avancuar aktivitetin e vet politik apo interesat e cilësdo organizatë tjetër të caktuar.
3. Avokati nuk mund të jetë anëtarë i dy apo më shumë Komiteteve apo organeve tjera të Odës.
4. Përjashtimisht delogatët e Odës mund të zgjedhen në vetëm një Komitet ose organ të Odës.

## **Neni 15**

Anëtarët e Komiteteve janë të obliguar që në punën dhe aktivitetin e vet përherë të udhëheqen nga parimet e përcaktuara me Ligjin për Avokatinë, Statutin e OAK-së, Kodin e Etikës dhe këtë Rregullore.

## **Kreu III MBIKËQYRJA, MONITORIMI DHE VLERËSIMI**

### **Neni 16**

Kryetari i Komitetit duhet ta informojë Këshillin Drejtues për ecurinë e punës dhe aktivitetet e Komitetit. Kryetari duhet t'i informojë anëtarët e Komitetit për përgjegjësit dhe vendimet e Këshillit Drejtues.

### **Neni 17**

Këshilli Drejtues i OAK-së do të sigurojë monitorimin e rregullt për të gjitha komitetet e formuara dhe të organizuara sipas kësaj rregulloreje. Monitorimi përfshinë mbikëqyrjen e punës, aktivitetin dhe shpenzimet e mjeteve të Komitetit. Për rezultatet e mbikëqyrjes do të informohet edhe Kuvendi i OAK-së.

## **Kreu IV SIGURIMI I KUSHTEVE PËR PUNËN E KOMITETEVE**

### **Neni 18**

1. Këshilli Drejtues i OAK-së është i detyruar që të sigurojë kushte për punën dhe aktivitetin e Komiteteve.
2. Mjetet për financimin e aktivitetit të Komiteteve vijnë nga Buxheti i OAK-së dhe burimet e tjera financiare.
3. Kryetari i Komitetit kujdeset që shpenzimi i mjeteve të lejuara të bëhen sipas buxhetit të aprovuar nga Këshilli Drejtues.

**Kreu V**  
**DISPOZITAT PER FUNDIMTARE**

**Neni 19**

1. Riorganizimi i Komiteteve sipas kësaj Rregullore do të bëhet më së voni në afat prej 3 muajsh prej hyrjes në fuqi të kësaj Rregulloreje, dhe shfuqizohet rregullorja paraprake.
2. Komitetet kanë obligim që t'i parashtrajnë Këshillit Drejtues planin e punës dhe draft buxhetin për vitin vijues më së voni deri në muajin nëntor.
3. Komitetet që nuk i përmbushin obligimet sipas par.2 të këtij neni do të shkarkohen nga ana e Këshillit Drejtues.

**Neni 20**

Rregullorja hynë në fuqi ditën e aprovimit nga Këshilli Drejtues i Odës së Avokatëve të Kosovës dhe zbatohet nga data 30.07.2020.

**Av.Behar Ejupi,**  
**Kryetar i OAK-së**